



TRANSFERTAT DALËSE Shërbimi i marrjes së SWIFT automatik

Platforma e-banking ju ofron mundësinë e kryerjes së transaksioneve pa u kufizuar në kohë, 24 orë në 7 ditë të javës. Për t'ju ofruar një shërbim sa më cilësor që përmbush në kohë nevojat tuaja, për çdo transfertë dalëse ne mund t'ju dërgojmë automatikisht mesazhin SWIFT (SWIFT- mesazh ndërbankar që paraqet të dhënat e transfertës së procesuar). Ai ju dërgohet nga sistemi me anë të e-mailit në adresën tuaj të deklaruar në bankë. Në këtë mënyrë ju keni konfirmimin që transfertat që urdhëruat u ekzekutua dhe fondet u debituan nga llogaria juaj.

ProCredit Bank ofron në mënyrë të vazhduar përmirësim dhe zhvillim të shërbimeve elektronike që ofron për ju. Kurseni kohë dhe para duke shfrytëzuar shërbimet elektronike të ProCredit Bank dhe përfitoni më tepër fleksibilitet në kryerjen e veprimeve tuaja të biznesit apo personale.

Për më shumë informacion rreth këtij shërbimi, jeni të lutur të kontaktoni informacion me Qendrën tonë të Kontaktit +355 4 2 389 389.

Siguria e të dhënave: ProCredit Bank është e angazhuar për mbrojtjen e integritetit të transaksioneve dhe detajeve të llogarisë suaj. Për këtë arsye, ProCredit Bank përdor programet kompjuterike dhe procedurat më të reja të sigurisë për të mbrojtur transaksionet tuaja online. Megjithatë, ju gjithnjë duhet të jeni të vetëdijshëm se Interneti dhe posta elektronike (e-maili) mund të përdoren si mjete për keqpërdorim, falsifikim, modifikim të informacionit të siguruar, që është përtej kontrollit të ProCredit Bank. Për shkak se informacioni për SWIFT që do dërgohet nga sistemi me anë të e-mailit përmban të dhëna konfidenciale shumë e rëndësishme që adresa/t e e-mailit që janë të deklaruar dhe regjistruara në bankë të jenë të sakta, të sigurt dhe në përdorim të klientit. Banka ProCredit duhet të sigurojë adresat tuaja të sakta të e-mailit dhe përditësojë ato në sistemin e saj, ndërsa klienti duhet që të informojë bankën mbi adresën/at e saktë të email-it dhe lajmërojë sa herë që ka ndryshime. Banka ProCredit nuk mban përgjegjësi nëse: email-i dërgohet në një adresë të gabuar e-maili që është dhënë nga vetë klienti, nëse adresa e e-mailit ka probleme sigurie, ose nëse zotëruesi i adresës ka ndryshuar. Klienti duhet të verifikojë gjithmonë që mesazhi është dërguar nga sistemi ynë dhe jo nga një adresë e klonuar.

Në rast se jeni i pasigurt për vërtetësinë e mesazhit, ju duhet të njoftoni bankën duke kontaktuar Qendrën e Kontaktit +355 4 2 389 389, e cila është në dispozicionin tuaj 24 orë në 7 ditë të javës. Është përgjegjësi e klientit që të informojë menjëherë bankën në rast se ai/ajo dyshon ose vërteton që një palë e tretë ka të drejtë hyrje në e-mailin e tij.